

Njoftim për punësim

Psikolog, për të ofruar shërbime mbështetëse të specializuara për fëmijën dhe familjen në Bashkinë Korçë

Pozicioni i punës	Psikolog
Periudha e kontraktimit	Maj 2025- Mars 2026
Zona e projektit	Bashkia Korçë
Data e mundshme e fillimit të punës	1 maj 2025
Lloji i kontratës	Kontratë pune me kohë të plotë (11 muaj)

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS kërkon të kontraktojë një psikolog, për të ofruar shërbime mbështetëse të specializuara për fëmijën dhe familjen në Bashkinë Korçë, në kuadër të programit Bashkimi Evropian për Kujdesin Social (EU4SocialCare) i financuar nga BE dhe i zbatuar nga UNICEF Albania dhe World Vision Albania.

Psikologu do të ketë për detyrë të zbatojë në kohë dhe me cilësi aktivitetet e projektit në Bashkinë Korçë, për mbështetjen e Bashkisë Korçë për të ofruar shërbime të specializuara në përputhje me nevojat e fëmijës dhe familjen pranë Shërbimit Mbështetës për Fëmijën dhe Familjen në Bashkinë Korçë.

Rreth Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS

isma për Ndryshim Shoqëror ARSIS (shkurtimisht NISMA ARSIS) është një organizatë jofitimprurëse, e cila është themeluar në shkurt të vitit 2016. NISMA ARSIS është një aktor jo qeveritar me influencë në sektorin e shoqërisë civile në Shqipëri.

Mision i NISMA ARSIS është angazhimi për avancimin e të drejtave të fëmijëve, të rinjve dhe familjarëve të tyre që përballen me vulnerabilitet, duke ofruar shërbime gjithëpërfshirëse dhe duke lehtësuar integrimin me dinjitet të tyre në shoqëri. NISMA ARSIS advokon dhe lobon në nivel lokal dhe qendror mbi çështjet e mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve, zhvillimit dhe pjesëmarrjes, përmirësimit të kushteve social-ekonomike të familjeve të tyre dhe fuqizimit të kapaciteteve të shërbim ofruesve, organizatave jofitimprurëse, profesionistëve dhe aktorëve të tjerë të cilët punojnë me fëmijët në situatë vulnerabël.

Përshkrimi i Projektit

Projekti po zbatohet në Bashkinë Korçë “Forcimi i krijimit dhe ofrimit të shërbimeve të kujdesit social për të mbrojtur fëmijët dhe komunitetet vulnerabël në Bashkinë e Korçës dhe Durrësit” në kuadër të programit Bashkimi Evropian për Kujdesin Social (EU4SocialCare) i financuar nga BE dhe i zbatuar nga UNICEF Albania dhe World Vision Albania. Metodologjia e propozuar bazohet në parimet e Konventës për të Drejtat e Fëmijës (CRC), standardeve ndërkombëtare të kujdesit alternativ për fëmijët dhe prioritetet kombëtare, duke përfshirë programin e Qeverisë së Shqipërisë, i cili synon të avancojë një sistem të mbrojtjes sociale gjithëpërfshirës dhe të përgjegjshëm për të mbështetur individët gjatë gjithë ciklit të jetës. Ajo përdor një model socio-ekologjik që vendos fëmijën në qendër të të gjitha ndërhyrjeve, i rrethuar nga katër shtresa kryesore: kujdestarët/familja, komuniteti, kultura dhe

shoqëria, si dhe mjedisi më i gjerë/politikat.

Në bashkinë Korçë, Qasja përqendrohet në krijimin e një modeli të plotë dhe multidisiplinor të shërbimeve, i cili ka në prioritet integrimin e kujdesit dhe mbrojtjes sociale, me fokus në përfitimet për fëmijët, mbështetjen familjare dhe përmirësimin e cilësisë dhe aksesit të shërbimeve të kujdesit. Nevojat e menjëhershme dhe afatgjata të fëmijëve adresohen përmes planeve të mbështetjes individuale dhe menaxhimit të integruar të rasteve. Këto përfshijnë këshillimin, terapinë dhe ndihmën psikosociale për të forcuar qëndrueshmërinë emocionale, së bashku me mbështetje të personalizuar arsimore dhe aktivitete të përfshirjes në komunitet. Qëllimi është të sigurohet që çdo fëmijë të zhvillohet në një mjedis të kujdesshëm që ka në prioritet mirëqenien, zhvillimin dhe ndjeshmërinë e tij/saj ndaj çështjeve gjinore. Projekti fuqizon kujdestarët, duke përfshirë familjet biologjike, ofruesit e kujdestarisë alternative dhe stafin institucional, me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të ofruar kujdes cilësor. Një fokus i veçantë i kushtohet përfshirjes aktive të baballarëve dhe kujdestarëve meshkuj, duke i inkurajuar ata të marrin pjesë në mënyrë aktive në rolet prindërore dhe të kujdesit. Kjo përfshin edhe fuqizimin e fuqisë punëtore të angazhuar në ofrimin e modeleve të reja të shërbimeve sociale, duke siguruar që shërbimet të adresojnë nevojat specifike si të grave ashtu edhe të burrave. Në bashkëpunim me Bashkinë e Korçës dhe aktorët lokalë, projekti forcon sistemet e mbështetjes të bazuara në komunitet. Këto përpjekje përfshijnë modelimin e shërbimeve të specializuara brenda Qendrës për Shërbime të Mbështetjes për Fëmijët dhe Familjet, duke siguruar që shërbimet të jenë të aksesueshme dhe të përshtatshme me kontekstin kulturor.

Nën mbështetjen dhe supervizimin e plotë të ekipit koordinues të programit, ***Psikologu, do të ketë këto përgjegjësi:***

- Identifikojë dhe vlerësojë nevojat e përfituesve, duke përdorur procedurat e standardizuara të menaxhimit të rastit në bashkëpunim me stafin e SHMFF, NJMF, NJVNR, aktorët lokalë dhe komunitetin.
- Identifikojë dhe shfrytëzojë në mënyrë optimale shërbimet e ofruara në komunitet, duke menaxhuar rastet dhe duke mobilizuar burimet ekzistuese për të adresuar nevojat e përfituesve.
- Angazhohet në punën në terren, duke realizuar vizita në familje dhe duke bashkëpunuar ngushtë me stafin e SHMFF, Drejtorinë e Shërbimit Social në Bashki dhe aktorët mbështetës në shërbim të komunitetit.
- Planifikojë dhe organizojë aktivitete, në përputhje me termat e projektit dhe kalendarin e punës, për të adresuar nevojat e identifikuar të përfituesve.
- Përgatisë dhe mirëmbajë dokumentacionin e nevojshëm, duke ndjekur procedurat financiare dhe administrative të projektit për të siguruar një regjistrim të saktë dhe të plotë të aktiviteteve.
- Raportoje te koordinatori i projektit, duke informuar për çdo rast të identifikuar gjatë vlerësimit në terren të fëmijëve në vështirësi dhe në nevojë për mbrojtje.
- Nxisë dhe përmirësojë aftësitë ndërvepruese të përfituesve, duke kryer vlerësime të thelluara, analizuar informacionin dhe përgatitur plane ndërhyrjeje për trajtimin e problematikave të identifikuar.
- Kryejë seanca individuale këshillimi, në varësi të nevojave të identifikuar, me fëmijët, adoleshentët dhe familjarët e tyre, në përputhje me detyrat e marra përsipër në GTN apo GMD.
- Përzgjedhë, administrojë dhe interpretojë teste psikologjike, për të vlerësuar zhvillimin mendor, social dhe emocional të përfituesve, qofshin ata të rritur apo fëmijë.
- Konceptojë, menaxhojë dhe realizojë aktivitete me qëllim psiko-social, duke synuar përmirësimin e sjelljes së fëmijëve dhe të rriturve që përfitojnë nga shërbimet e programit.

- Respektojë Kodin e Etikës në punën me fëmijët, duke treguar kujdes gjatë përdorimit të materialeve promovuese dhe duke mbajtur parasysh parimet e mosdiskriminimit, konfidencialitetit dhe interesit më të lartë të fëmijës.
- Informojë dhe këshillojë familjet për shërbimet dhe aktivitetet në komunitet, si dhe për shërbimet në nivel bashkie, për të siguruar mbështetje të integruar dhe reagim të shpejtë ndaj nevojave të tyre.
- Mbikëqyrë dhe monitorojë vazhdimisht ecurinë e rasteve, duke vlerësuar përshtatshmërinë e shërbimeve të ofruara dhe duke bërë ajustimet e nevojshme për të përmbushur nevojat e përfituesve.

Kualifikimet:

- Diplomë universitare në Shkencat Sociale.
- Kualifikime që lidhen me çështje të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe familjeve si dhe të zhvillimit të fëmijëve;

Eksperiencat:

- Të ketë experience pune mbi 3 vjet në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve, shërbimet shoqërore dhe punës për fuqizimin e familjeve dhe komunitetit;
- Eksperienca të mëparshme në organizata partnere të shoqërisë civile (preferohet);
- Të jetë njohës shumë i mirë i paketës ligjore për politikën e mbrojtjes së fëmijëve;
- Të ketë njohuri shumë të mira në menaxhimin e rasteve, veçanërisht me fëmijët jashtë kujdesit prindëror apo në kujdes alternativ;
- Aftësi shumë të mira komunikimi dhe nderveprimi në punën në grup;
- Njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe dhe të gjuhës angleze;
- Aftësi shumë të mira të përdorimit të kompjuterit, paketa Microsoft Word, Excel, email, etj
- I/e gatshëm/e për të udhëtuar/lëvizur në terren;
- Të kuptojë dhe të dakortësojë me misionin dhe qëllimin e Nisma ARSIS dhe Politikën e Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri;

Politikat e Mbrojtjes së Fëmijëve: Të gjithë personat që punojnë me programet e Nisma ARSIS janë të detyruar të respektojnë politikën e mbrojtjes së fëmijëve, politikën e mbrojtjes nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, rregulloren e brendshme të Nisma ARSIS, kodin e sjelljes, Legjislacionin e plotë për Mbrojtjen e Fëmijëve si dhe çdo dokument tjetër për të cilin duhet të ketë dijeni.

Procedura e aplikimit:

Personat e interesuar duhet të dergojnë së bashku me kërkesën për aplikim në email ose me postë edhe dokumentat si më poshtë:

- një kopje të jetëshkrimit profesional (CV)
- një letër interesi

brenda datës 20 prill 2025 në info@nisma-arsis.org , ose në adresën: Rruga "Sali Butka", Pallati T.B.M, Shkalla 2, Apartamenti 1, Kati 1, Njesia Bashkiake Nr.7, PC 1023, Tirana Albania.

Ju lutemi, në vemendjen tuaj që:

- në subjekt të emailit ose zarfit ku dërgohet aplikimi të vendoset: **Aplikim për pozicionin e psikologut për shërbime mbështetëse të specializuara në Bashkinë Korçë**
- vetëm personat e përzgjedhur për intervistë do të kontaktohen.